VENDIM
Nr. 133, datë 2.3.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH, TË LETËRMARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA SEKRETARIATI I SHTETIT, PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE (SECO) TË QEVERISË ZVICERANE, NËN FONDIN E BESIMIT ME SHUMË DONATORË, PËR FUQIZIMIN E KONTABILITETIT DHE MJEDISIT TË MIRËBESIMIT NË EVROPËN JUGORE DHE AZINË QENDRORE, PËR PROJEKTIN E ZHVILLIMIT TË KONTABILITETIT NË SEKTORIN PUBLIK, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 251, DATË 9.5.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash, të letërmarrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të qeverisë zvicerane, nën Fondin e Besimit me Shumë Donatorë, për fuqizimin e kontabilitetit dhe mjedisit të mirëbesimit në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, për projektin e zhvillimit të kontabilitetit në sektorin publik, miratuar me vendimin nr. 251, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Logo **BANKA BOTËRORE**
BNRZH – IDA/GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienë, Austri, 1020

LINDA VAN GELDER
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

22 dhjetor 2021

Sh. s. znj. Delina Ibrahimaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
SHQIPËRI

E nderuar znj. Ministre,

Shqipëri - Projekti i Zhvillimit të Kontabilitetit të Sektorit Publik
Granti SAFE nr. TFOA3277 dhe Granti SAFE nr. TF0A5134
Zgjatja e afatit të mbylljes së projektit

I referohemi letërmarrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), i cili vepron si administrator i fondeve të grantit të ofruar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të Qeverisë Zvicerane (Donatori) nën Fondin e Mirëbesimit me Shumë Donatorë për Forcimin e Përgjegjshmërisë dhe Mjedisit të Besimit në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, të datës 3 prill 2018 për Projektin e Zhvillimit të Kontabilitetit të Sektorit Publik (Projekti) dhe letrës suaj të datës 26 qershor 2020, duke kërkuar nga Banka Botërore zgjatjen e afatit të mbylljes së grantit të mësipërm të parashikuar, sipas letërmarrëveshjes nga 31 dhjetor 2021 në 31 dhjetor 2022.

Kemi kënaqësinë t'iu informojmë se Banka Botërore ka caktuar datën 31 dhjetor 2022, si datë të mëvonshme për qëllimet e nenit III, 3.03 të aneksit të letërmarrëveshjes.

Me respekt,

(Nënshkrimi)
Linda Van Gelder
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

Për dijeni: Znj. Adela Xhemali, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë
Z. Patrik Meier, zëvendësdrejtues i Misionit, Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të Qeverisë Zvicerane
Znj. Veronika Korkaj, Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe donatorëve të tjerë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Znj. Majlinda Dhuka, zëvendëssekretare e Përgjithshme dhe Drejtore e Përgjithshme e Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisjen
Z. Matteo Bugamelli, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore

Tel.: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701